

Ardjan Takaj: Tek Skenderbeu te gjithe jane paguar rregullisht

nga AlbaniaSoccer

E mërkurë, 27 Nentor 2013 17:59



Presidenti i Skenderbeut Ardjan Takaj ka treguar se tek skuadra e tij nuk ka probleme pagesash dhe se pezullimi i mbrojtësit Gvozdenovic është bërë për arsye të tjera disiplinore. Dëshiroj të përgënjeshtror fjalet se tek "Skenderbeu" ka pagesa të pashlyera. Dëshiroj t'iu them se tek skuadra ime nuk ka asnjë problem pagesash dhe të gjitha dëryrimet kundër futbollistëve janë shlyer në masën 100%. Këto janë shkrime dashakeqe dhe të qellimshme ndaj klubit tonë. Tek Skenderbeu nuk ka pasur dhe nuk do ketë probleme pagesash", ka deklaruar të mërkurën presidenti i skuadës kampione.